



BLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Sek. Arsimimit
8.6.21
[Signature]

Nr. 924 prot.

Tiranë, më 03.06.2021

URDHËR

Nr. 756, datë 03.06.2021

PËR

DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË MBROJTJES NR. 9, DATË 31.12.2018 "PËR PROCEDURAT DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË USHTARËVE/DETARËVE AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në germën "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në pikën 1 dhe 4, të nenit 15, të ligjit 59/2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Në udhëzimin e ministrit të Mbrojtjes nr. 9, datë 31.12.2018 "Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të bëhen disa ndryshime, si më poshtë vijon:
 - a) Kudo në këtë udhëzim, ku gjendet emërtimi "KDS" ose KDS/AFA", ndryshon dhe bëhet "AFA";
 - b) Në pikën 2, të kreut II, të këtij udhëzimi, fjalët "të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit", ndryshojnë dhe bëhen "minimalisht të ketë kryer arsimin 9-vjeçar brenda ose jashtë vendit";
 - c) Në germën "a", të pikës 4.1, të kreut II, të këtij udhëzimi, fjalët "fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar e noterizuar dhe certifikatën e maturës shtetërore të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore rajonale/e rrethit ose të arsimit të lartë të noterizuar" ndryshojnë dhe bëhen "fotokopje të certifikatës së arsimit 9-vjeçar ose të diplomës së arsimit mesëm, ose të arsimit të lartë të noterizuar".

2. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri: komandantët e Forcave, komandanti i Komandës Mbështetëse, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandantët e reparteve të varësisë së drejtpërdrejtë, Qendra e Personel-Rekrutimit, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Njësia Mjekësore Ushtarake dhe drejtoritë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.
3. Ndjekin zbatimin e këtij urdhri shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe sekretari përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI
Niko Peleshi

